



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Na osnovu ovlašćenja definisanim članom 64.2, tačka (g), čl. 7. 1 tačka (a) i (b), čl. 7.2 i 8.6 Zakona br.03/L-073 o Opštim Izborima u Republici Kosovo, Centralna Izborna Komisija, na održanom sastanku na 19.11.2020, donosi:

ODLUKA

O Potvrđivanju Konačnog Biračkog Spiska za Vanredne Izbore za Gradonačelnika u opštinama Podujevo i Severna Mitrovica

- I. Potvrđuje se Konačni Birački Spisak za vanredne izbore za Gradonačelnika u opštinama Podujevo i Severna Mitrovica, koji će se održati 29. novembra 2020.
- II. Konačni izveštaj o potvrđivanju Konačnog Biračkog Spiska, kao u tački I ove odluke je sastavni deo ove odluke.
- III. Obavezuje se Sekretarijat CIK-a za sprovođenje ove odluke.
- IV. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Priština, 19.11.2020

Predsednica Centralne Izborne Komisije

Valdete Daka



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e
Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut

29 nëntor 2020

Lista Përfundimtare e Votuesve

2020

PËRMBAJTJA

QËLLIMI.....	3
PËRMBLEDHJE.....	3
PËRSHKRIM.....	4
APLIKIMI I VOTUVE ME KUSHT.....	7
PERIUDHA E SHËRBIMIT TË VOTUESVE.....	8
PRANIMI I SHKRESËS NGA KËSHILLIT GJYQËSORË.....	9
VOTIMI JASHTË KOSOVËS.....	9
PERIUDHA E KUNDËRSHTIMIT DHE KONFIRMIMIT E LISTËS SË VOTUESVE.....	10
KRIJIMI I LISTËS PËRFUNDIMTARE TË VOTUESVE.....	11
REKOMANDIMET PËR AGJENCINË E REGJISTRIMIT CIVIL.....	11
PËRMBLEDHJET TABELORE (Numri i votuesve, numri i QV, numri i VV dhe numri i votuesve për qendra të votimit).....	12
SHTOJCA 1: Shembull se si duken faqet e Listës Përfundimtare të Votuesve për vendvotimin e rregullt.	

Qëllimi

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është e obliguar që të certifikoj listën e votuesve në raport me zgjedhjet e caktuara¹. Ky dokument e mbështetë procesin e certifikimit të listës së votuesve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, që do të mbahen me datën 29 nëntor 2020.

Përmbledhje

Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV 2020) për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Qendror Civil². Ky ekstrakt është përpiluar nga Agjencia e Regjistrimit Civil, gjegjësisht Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve (DPA), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

- I. Lista Përfundimtare e Votuesve 2020 për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në Komunën e Podujevës përmban:
 1. 87,381 emra të votuesve, me dallim prej 552 votues më shumë, në krahasim me Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës, të datës 15 mars 2020 për komunën e Podujevës³, të cilat zgjedhje janë shtyre për shkak të situatës me pandeminë Covid-19 .
 2. Numri i Qendrave të Votimit (QV) është dyzet e pesë (45).
 3. Numri i vendvotimeve është njëqind e pesëmbëdhjetë (115).

¹ Ligji Nr. 03/L-256, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 64.2, pika (g).

² Ibid, Neni 7.1, pika (a) dhe (b).

³ Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës 15 mars 2020, Lista përfundimtare e votuesve për komunën e Podujevës, ka përmbajtur gjithsejtë: 86,610 votues plus 219 votues të regjistruar jashtë Kosovës për komunën e Podujevës 86,829.

II. Lista Përfundimtare e Votuesve 2020 për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut përmban:

1. 23,313 emra të votuesve, me dallim prej 489 votues më shumë, në krahasim me Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 6 tetor 2019 për komunën e Mitrovicës së Veriut⁴.
2. Numri i Qendrave të Votimit (QV) është shtatë (7).
3. Numri i vendvotimeve është njëzet e shtatë (27).

Përshkrimi

Pas pranimit të ekstraktit nga Regjistri Qendror Civil⁵, Divizioni i Shërbimit të Votuesve, ka bërë caktimin e votuesve në qendra të votimit.

Për komunën e Podujevës:

Numri i votuesve të rinj dhe numri i votuesve të regjistruar për herë të parë në komunën e Podujevës, e të cilët do të kenë mundësi që të votojnë, në Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës, më 29 nëntor 2020, është: 1,686 votues.

- a) 1,400 votues të rinj që pas Zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës 15 mars 2020, kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës më 29 nëntor 2020⁶.
- b) 286 votues që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve në Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës 15 mars 2020, e që konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil midis dy palë zgjedhjesh ose votues që kanë ndërruar adresë, prej komunave tjera të Republikës së Kosovës, në komunën e Podujevës.
- c) 219 votues janë kthyer në listën përfundimtare të votuesve në Komunën e Podujevës, të cilët në Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e

⁴ Në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Lista përfundimtare e votuesve për komunën e Mitrovicës së Veriut, ka përmbajtur gjithsejtë: 22,457 votues plus 367 votues të regjistruar jashtë Kosovës për komunën e Mitrovicës së Veriut 22,824.

⁵ Rregulla Zgjedhore Nr. 2/2013, Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Neni 3.2 dhe 3.3.

⁶ Votuesit, të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeç pas datës 15 mars 2020 (pas Zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës 15 mars 2020) për Komunën e Podujevës dhe që do t'i mbushin 18 vjeç me datën 29 nëntor 2020.

Podujevës 15 mars 2020, u patën regjistruar suksesshëm si votues jashtë Kosovës, dhe të cilët u patën larguar nga lista përfundimtare e votuesve brenda Kosovës, për komunën e Podujevës⁷.

Numri i votuesve që janë larguar, nga lista përfundimtare e votuesve, krahasuar me listën e votuesve të komunës së Podujevës për Zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës 15 mars 2020, është: **460 votues**.

Shpjegimet sipas kategorive:

- Numri i emrave të personave që janë larguar si të vdekur pas Zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës 15 mars 2020, për Komunën e Podujevës, është: **398 votues**.
- Numri i votuesve që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës pas Zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës 15 mars 2020, për Komunën e Podujevës, është: **62 votues**.
- Numri i votuesve që janë larguar nga lista përfundimtare e votuesve në vendvotime, si rezultat që kanë aplikuar suksesshëm për regjistrim për të votuar përmes postës, për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës, është: **387 votues**.
- Numri i votuesve që janë larguar si rezultat që iu është marrë zotësia e veprimit nga Gjykata Themelore Prishtinë – dega Podujevë: **9 votues**.
- Numri i votuesve që janë larguar nga lista përfundimtare e votuesve të Komunës së Podujevës, si rezultat që kanë ndërruar adresë në komunat tjera: **278 votues**.

Për komunën e Mitrovicës së Veriut:

Numri i votuesve të rinj dhe numri i votuesve të regjistruar për herë të parë në komunën e Mitrovicës së Veriut, e të cilët do të kenë mundësi që të votojnë, në Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Mitrovicës së Veriut, më 29 nëntor 2020, është: **765 votues**.

- a) **177 votues** të rinj që pas Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019 në komunën e Mitrovicës së Veriut, kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe që do të votojnë për herë të parë në

⁷ 219 votues janë kthyer në listën preliminare të votuesve në Komunën e Podujevës, të cilët në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës 15 mars 2020, u patën regjistruar si votues jashtë Kosovës, dhe të cilët u patën larguar nga lista përfundimtare e votuesve brenda Kosovës, për komunën e Podujevës.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut më 29 nëntor 2020⁸.

- b) 588 votues që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, e që konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil midis dy palë zgjedhjesh ose votues që kanë ndërruar adresë, prej komunave tjera të Republikës së Kosovës, në komunën e Mitrovicës së Veriut.
- c) 367 votues janë kthyer në listën përfundimtare të votuesve në Komunën e Podujevës, të cilët në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, u patën regjistruar suksesshëm si votues jashtë Kosovës, dhe të cilët u patën larguar nga lista përfundimtare e votuesve brenda Kosovës, për komunën e Mitrovicës së Veriut⁹.

Numri i votuesve që janë larguar, nga lista përfundimtare e votuesve, krahasuar me listën e votuesve të komunës së Mitrovicës së Veriut për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, është: 173 votues.

Shpjegimet sipas kategorive:

- Numri i emrave të personave që janë larguar si të vdekur pas Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 6 tetor 2019, për Komunën e Mitrovicës së Veriut, është: 166 votues.
- Numri i votuesve që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës pas Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 6 tetor 2019, për Komunën e Mitrovicës së Veriut, është: 7 votues.
- Numri i votuesve që janë larguar nga lista përfundimtare e votuesve në vendvotime, si rezultat që kanë aplikuar suksesshëm për regjistrim për të votuar përmes postës, për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Mitrovicës së Veriut, është: 2 votues.
- Numri i votuesve që janë larguar nga lista përfundimtare e votuesve të Komunës së Mitrovicës së Veriut, si rezultat që kanë ndërruar adresë në komunat tjera: 101 votues.

⁸ Votuesit, të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeç pas datës 6 tetor 2019 (pas datës së Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës) për Komunën e Mitrovicës së Veriut dhe që do t'i mbushin 18 vjeç me datën 29 nëntor 2020.

⁹ 367 votues janë kthyer në listën preliminare të votuesve në Komunën e Mitrovicës së Veriut, të cilët në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, u patën regjistruar si votues jashtë Kosovës, dhe të cilët u patën larguar nga lista përfundimtare e votuesve brenda Kosovës, për komunën e Mitrovicës së Veriut.

Aplikimi i votave me kusht nga Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2020

Për çdo proces zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, analizon votat me kusht të zgjedhjeve të fundit, dhe i aplikon ato, për zgjedhjet që mbahen.

Komuna e Podujevës

Në komunë e Podujevës, në zgjedhjet parlamentare të datës 6 tetor 2019, numri total i votave me kusht të konfirmuara, ka qenë 927.

Prej 927 votues që në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, kishin votuar me kusht në komunën e Podujevës, Divizioni i Shërbimit të Votuesve, votuesit që kanë votuar me kusht i cakton në ato qendra të votimit ku kanë votuar me kusht.

Numri i caktuar i votuesve në qendrat e votimit që kanë votuar me kusht, për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës, është: 412 votues.

Ndërsa, aplikimi i votave me kusht për votuesit që kanë votuar me kusht në qendra të votimit në komunën e Mitrovicës së Veriut, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, nuk është bërë për 515 votues, për këto arsye:

- 120 votues kanë votuar me kusht, në atë qendër të votimit, ku kanë qenë sipas listës përfundimtare të votuesve për këtë komunë.
- 367 votues që kanë votuar me kusht, votat e të cilëve janë konfirmuar, meqenëse në zgjedhjet parlamentare, Republika e Kosovës konsiderohet një zonë zgjedhore, e që vota e hedhur me kusht numërohet, pavarësisht se votuesi nuk ka qenë në listën përfundimtare të komunës së Mitrovicës së Veriut. Ndërsa, në zgjedhjet për kryetar komunë, meqenëse komuna konsiderohet si zonë e veçantë zgjedhore, qendra e votimit ku këta 367 votues kanë votuar me kusht nuk është aplikuar, për arsye se të dhënat për adresën, i përkasin komunave tjera.
- 28 vota me kusht nuk janë aplikuar, për arsye se 28 votues që kanë votuar me kusht, kanë qenë anëtar të Këshillave të Vendvotimit, të cilët kanë votuar me kusht në qendrat e votimit ku kanë shërbyer në ditën e zgjedhjeve.

Komuna e Mitrovicës së Veriut

Në komunë e Mitrovicës së Veriut, në zgjedhjet parlamentare të datës 6 tetor 2019, numri total i votave me kusht të konfirmuara, ka qenë 520.

Prej 520 votues që në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, kishin votuar me kusht në komunën e Mitrovicës së Veriut, Divizioni i Shërbimit të Votuesve, votuesit që kanë votuar me kusht i cakton në ato qendra të votimit ku kanë votuar me kusht.

Numri i caktuar i votuesve në qendrat e votimit që kanë votuar me kusht, për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Mitrovicës së Veriut, është: 87 votues.

Ndërsa, aplikimi i votave me kusht për votuesit që kanë votuar me kusht në qendra të votimit në komunën e Mitrovicës së Veriut, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, nuk është bërë për 459 votues, për këto arsye:

- 49 votues kanë votuar me kusht, në atë qendër të votimit, ku kanë qenë sipas listës përfundimtare të votuesve për këtë komunë.
- 384 votues që kanë votuar me kusht, votat e të cilëve janë konfirmuar, meqenëse në zgjedhjet parlamentare, Republika e Kosovës konsiderohet një zonë zgjedhore, e që vota e hedhur me kusht numërohet, pavarësisht se votuesi nuk ka qenë në listën përfundimtare të komunës së Mitrovicës së Veriut. Ndërsa, në zgjedhjet për kryetar komunë, meqenëse komuna konsiderohet si zonë e veçantë zgjedhore, qendra e votimit ku këta 384 votues kanë votuar me kusht nuk është aplikuar, për arsye se të dhënat për adresën, i përkasin komunave tjera.
- 26 vota me kusht nuk janë aplikuar, për arsye se 26 votues që kanë votuar me kusht, kanë qenë anëtar të Këshillave të Vendvotimit, të cilët kanë votuar me kusht në qendrat e votimit ku kanë shërbyer në ditën e zgjedhjeve.

Periudha e shërbimit të votuesve

Periudha e Shërbimit të Votuesve për Ndërrimin e Qendrave të Votimit ka filluar me datën 30 tetor 2020 dhe ka përfunduar me datën 14 nëntor 2020.

Gjatë kësaj kohe, të gjithë votuesit kanë pasur mundësi të informohen se në cilën qendër të votimit janë caktuar të votojnë ose të kërkojnë ri-caktim të qendrës së votimit më të përshtatshme për ta.

Gjatë kësaj periudhe, makina kërkuese e publikuar në ueb faqen e KQZ-së¹⁰, është shfletuar 5,655 herë.

Nga data 30.10.2020 deri me datën 14.11.2020, gjashtëdhjetë e pesë (65) votues kanë parashtruar kërkesa për ndërrimin e qendrave të votimit.

¹⁰ <http://eomp.kqz-ks.org/VCChangeRequests/Index>

- a) Gjashtëdhjetë e tre (63) kërkesa për ndërrim të qendrave të votimit janë parashtruar për Komunën e Podujevës, ku 52 janë parashtruar në zyrën e KKZ-së në këtë komunë, ndërsa 11 kërkesa janë parashtruar përmes platformës online për ndërrimin e qendrës së votimit, dhe
- b) Dy (2) kërkesa për ndërrimin e qendrave të votimit janë parashtruar për Komunën e Mitrovicës së Veriut, ku këto dy kërkesa janë parashtruar përmes platformës online për ndërrimin e qendrës së votimit.

Për të dy komunat:

- 65 kërkesa për ndërrimin e qendrës së votimit janë aprovuar,

Pas kësaj periudhe, Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka vendosur të gjitha ndryshimet në listën e votuesve, e cila më pas është integruar në ekstraktin e fundit që është pranuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil/ Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve.

Pranimi i Shkresës nga Këshilli Gjyqësorë i Republikës së Kosovës

Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 02/ 2013, me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me datën 10.11.2020 nga Këshillit Gjyqësor i Republikës së Kosovës kemi pranuar listën me **njëzet (20)** emra të personave që u është marrë zotësia e veprimit nga Gjykata Themelore Prishtinë – dega në Podujevë

Nga analizimi i këtyre të dhënave me numër personal, me emër, mbiemër, datë të lindjes, emër të prindit, dhe vendbanime, janë identifikuar nëntë (9) persona, të cilët janë hequr nga Lista përfundimtare e votuesve.

Votimi jashtë Kosovës

Programi i Votimit jashtë Kosovës, Periudha e Aplikimit për Regjistrimit është ndërmarrë prej datës 30 tetor 2020 deri me datën 7 nëntor 2020. Divizioni i Shërbimit të Votuesve, përmes e-mailit ka dërguar aplikacione për regjistrim, votuesve të regjistruar suksesshëm në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2019, që vendbanimin brenda Kosovës, sipas regjistrimit qendror civil e kanë në komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut. Informatat e nevojshme dhe formularët për regjistrim janë publikuar në ueb faqen zyrtare të KQZ-së.

Përgjatë periudhës së aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, përmes e-mailit, janë pranuar 450 aplikacione për regjistrim.

- a) Të regjistruar si votues të suksesshëm: 427

- 424 votues të aprovuar në komunën e Podujevës, dhe

- 3 votues të aprovuar në komunën e Mitrovicës së Veriut

b) Të refuzuar: 23 aplikacione për regjistrim:

- 1 aplikues janë refuzuar për shkak se kanë dërguar vetëm formularin e regjistrimit.
- 19 aplikues janë refuzuar, për shkak që nuk ka vendbanim në komunën e Podujevës, votues të komunave të tjera
- 1 aplikues është refuzuar, për shkak se nuk e kanë përmbushur kriteret e zotësisë juridike,
- 1 aplikues është refuzuar për shkak se ka dërguar formularin e aplikimit për regjistrim të Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- 1 aplikues është refuzuar për shkak se Kanë aplikuar brenda Kosovës nuk ka dëshmuar adres jashtë Kosovës

Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 03/ 2013 Votimi jashtë Kosovës, votuesit që kanë aplikuar suksesshëm dhe që janë shtetas të Republikës së Kosovës, janë larguar nga lista e votuesve brenda vendit që përdoret në vendvotime, në Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut¹¹.

Numri i votuesve që janë larguar nga Lista Përfundimtare e Votuesve që përdoret në vendvotime në komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, është: 389 votues.

Periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit e listës së votuesve

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit të Listës së Votuesve ka filluar me datën 11 nëntor 2020 dhe ka përfunduar me datën 14 nëntor 2020. Gjatë kësaj periudhe, votuesit kanë pasur mundësi që ta sfidojnë Listën preliminare të votuesve në gjykatat e shkallës së parë.

Sekretariati i KQZ-së, para fillimit të Periudhës së Konfirmimit dhe Kundërshtimit të Listës së Votuesve, i ka njoftuar personat kontaktues të subjekteve politike të certifikuar për zgjedhje, për tu pajisur me CD-të që kanë përmbajtur Listën Preliminare të Votuesve¹².

Gjatë kësaj periudhe, asnjë votues nuk ka konfirmuar dhe kundërshtuar të dhënat në Listën e Votuesve.

Krijimi i LPV-së

¹¹ Rregulla Zgjedhore Nr. 03/2013 Votimi jashtë Kosovës, Neni 3.8.

¹² Rregulla Zgjedhore Nr.2/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Neni 5.1.

Pas përfundimit të Periudhës së Shërbimit të Votuesve dhe Periudhës së Konfirmimit dhe Kundërshtimit të LV-së, Divizioni për Shërbim të Votuesve i ka caktuar votuesit nëpër vendvotime sipas renditjes alfabetike. Të dhënat e reja janë shtypur në format PDF dhe kualiteti është kontrolluar nga ana e Divizionit të Shërbim të Votuesve. Këto dokumente janë të gatshme për t'ju dërguar kompanisë e cila do ta bëjë shtypjen e Listës Përfundimtare të Votuesve 2020.

Rekomandimet për Agjencinë e Regjistrimit Civil/ Regjistrin Qendror Civil

Divizioni i Shërbimit të Votuesve vlerëson bashkëpunimin e ngushtë dhe profesional me Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Nga procesi i krijimit të listës së votuesve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut kemi vërejtur se ka përmirësim të dukshëm në standardizimin e emrave të vendbanimeve, konkretisht emrat e fshatrave.

Por, shqetësuese mbetet cilësia e të dhënave që votuesit kanë në fushën e emrave të rrugëve, të cilat nuk janë të emërtuara sipas sistemit unik të adresave, dhe gjithashtu emrat e rrugëve, nuk përmbajnë elementet e plota për adresën.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për Agjencinë e Regjistrimit Civil rekomandon:

- a) MPB/ Agjencia për Regjistrim Civil, duhet t'i reflektoj ndryshimet që kanë të bëjnë me standardizimin e emrave të rrugëve, me të gjithë përbërësit e adresave.
- b) MPB/ Agjencia për Regjistrim Civil, duhet që të bëjë përpjekje që qendrat komunale të regjistrimit civil të bëjnë ndryshimet me kohë, të cilat reflektojnë pas aplikimit për dokumente identifikuese nga shtetasit e Republikës së Kosovës.

Përmbledhjet tabelore

1. Numri i votuesve, Numri i Qendrave të Votimit dhe Numri i Vendvotimeve për komunat e Republikës së Kosovës.

Kodi Komunal	Komunat	Numri i votuesve	Numri i Qendrave të Votimit	Numri i Vendvotimeve
18	Podujevë	87,381	45	115
38	Mitrovicë e Veriut	23,313	7	27

2. Numri i votuesve për qendra të votimit – Komuna e Podujevës.

Emërtimi i Qendrës së Votimit	Qendra e Votimit	Nr. i votuesve për Qendra të Votimit
SHKOLLA E MESME TEKNIKE "FAN S. NOLI"	1801E	4450
GJIMNAZI "ALEKSANDËR GJUVANI"	1801X	3536
SHKOLLA FILLORE "SHABAN SHALA"	1802E	4131
SHKOLLA FILLORE "NAIM FRASHËRI"	1802X	3390
SHKOLLA FILLORE "AFRIMI E FAHRIU"	1803E	2806
SHKOLLA FILLORE "HAMIT SEJDIU"	1804E	2116
SHKOLLA FILLORE "SHEFKI LATIFI"	1805E	866
SHKOLLA FILLORE "SAMI FRASHËRI"	1806E	605
SHKOLLA FILLORE "NUHI GASHI"	1807E	2571
SHKOLLA FILLORE "EMIN DURAKU "	1808E	1964
SHKOLLA FILLORE "ESAT MEKULI"	1809E	1461
SHKOLLA FILLORE "NAUM VEQILHARXHI"	1810E	1861
SHKOLLA FILLORE "ALI HADRI"	1811E	862
SHKOLLA FILLORE "KONGRESI I MANASTIRIT"	1812E	2885
SHKOLLA "HASAN RAMADANI"	1813E	1470
SHKOLLA FILLORE "ALI AJETI"	1814E	2500
SHKOLLA FILLORE "SHEQË MIROVCI"	1815E	1798
SHKOLLA FILLORE "LUIGJ GURAKUQI"	1816E	2654
SHKOLLA FILLORE "SHEFKI KULETA"	1817E	1358
SHKOLLA FILLORE "ZAHIR PAJAZITI"	1818E	1462
SHKOLLA FILLORE "DRITA"	1819E	2019
SHKOLLA FILLORE "LASGUSH PORADECI"	1820E	2830
SHKOLLA FILLORE "KADRI KADRIU"	1821E	592
SHKOLLA FILLORE "ALI HADRI"	1822E	1469
SHKOLLA FILLORE "SHEFKI KULETA"	1823E	1315
SHKOLLA E MESME EKONOMIKE "ISA BOLETINI"	1824E	13095
SHKOLLA FILLORE "KONGRESI I MANASTIRIT"	1825E	484
SHKOLLA FILLORE "ZENEL HAJDINI"	1827E	2043
SHKOLLA FILLORE "RILINDJA"	1828E	669
SHKOLLA FILLORE " ALI AJETI"	1829E	1625

SHKOLLA FILLORE "ELFIR BEHRAMI"	1830E	1218
SHKOLLA FILLORE "JETULLAH GASHI"	1831E	1452
SHKOLLA FILLORE "PAVAREZIA"	1832E	1527
SHKOLLA FILLORE "HYZRIU E SAMIU"	1833E	1611
SHKOLLA FILLORE "ILIR KONUSHEFCI"	1834E	1313
SHKOLLA FILLORE "EQREM QABEJ"	1835E	967
SHKOLLA FILLORE "JETULLAH ISLAMI"	1836E	647
SHKOLLA FILLORE "LUIGJ GURAKUQI"	1837E	1188
SHKOLLA FILLORE "ALI AJETI"	1838E	792
SHKOLLA FILLORE "DITURIA"	1839E	1271
SHKOLLA FILLORE "KADRI KADRIU"	1840E	913
SHKOLLA FILLORE "ALI HADRI"	1841E	1193
SHKOLLA FILLORE "JAHE HASANI"	1842E	304
SHKOLLA FILLORE "MUSLI DUMOSHI"	1843E	1093
SHKOLLA FILLORE "HAMIT SEJDIU "	1844E	1005
TOTALI		87,381

3. Numri i votuesve për qendra të votimit – Komuna e Mitrovicës së Veriut.

Emërtimi i Qendrës së Votimit	Qendra e Votimit	Nr. i votuesve për Qendra të Votimit
OBJEKT PRIVAT	3801B	872
OBJEKT PRIVAT RR.SAMI FRASHERI (NEMANINJA)	3802B	1621
SHKOLLA "AZIZ SYLEJMANI"	3803B	1316
SHKOLLA FILLORE "SVETI SAVA" P.N	3804B	183
SHKOLLA FILLORE "SVETI SAVA"	3805B	11322
SHKOLLA TEKNIKE	3805X	7054
SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË	3806B	945
TOTALI		23,313



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



01. DEÇAN/DEČANE



0101C/01R

720

Votues në listë
Biračka na spisku

3

Faze të tretës përfundimtare të votuesve
Stranica konačnog biračkog spiska

SHENIMBUJLL

Mbiemri
Prezime

Emri
Ime

BBBBBBBB, AAAAAAAAAA

04/05/1983

1234567890



Data e lindjes
Datum rođenja

Numri i regjistrimit
Registarski broj

Nënshkrimi i votuesit
Potpis biračah

PEKUNËCI KËNDIN E POSHTËM TË DJATHTË TË ASAJ FAQE. NËSE VENDOSEN SHENJA NË CILËNDO PJESË TË LISTËS PËRFUNDIMTARE TË VOTUESVE, ATO DO TË PENGOJNË PROCESIN E SKENIMIT.

ËNËSHKRIMI I VOTUESIT
POTPIS BIRAČAH
PËR ÇDO STRANICË, PREBROJITE POTPISË I BROJ UPIŠITE U KVADRATICË U DOJNEM DESNOM UGLU TË STRANICE. ZNACI STAVLJENI BILO GDE DRUGDE NA KONAČNOM BIRAČKOM SPISKU OMETAJU PROCES SKENIRANJA.





LIONEL MESSI 01/01/1999 1111111111	LIONEL MESSI 01/01/1999 1111111111
LIONEL MESSI 01/01/1999 1111111111	LIONEL MESSI 01/01/1999 1111111111
MESS, LIONEL 01/01/1999 1111111111	MBAPE, KYLIAN 02/02/1998 2222222222
MALDINI, PAOLI 03/03/1989 3333333333	ZIDANE, NEDIN 04/04/1979 4444444444
SALAH, MOHAMED 05/05/2000 5555555555	RONALDO, CRISTIANO 06/06/1988 6666666666
HAZARD, EDEN 07/07/1997 7777777777	MARQUEZ, LUIS 08/08/2001 8888888888
AGUERO, SERGIO 09/09/1989 9999999999	LEWANDOSKI, ROBERT 10/10/1985 1111222222
DE BRUYNE, KEVIN 11/11/1993 2222221111	WEAH, GEORGE 12/12/1976 3333222222
TOTTI, FRANCESCO 01/11/1980 1111555555	BARESI, FRANKO 31/02/2002 5555511111
ETO, SAMUEL 21/05/1985 9999955555	NESTA, ALEKSANDER 22/02/2000 1111666666



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



25. FERIZAJ/UROŠEVAC



2501D/11D

LISTA E VOTUESVE ME KUSHT
SPISAK USLOVNIH BIRAČA

Faqetë listës së votuesve me kusht
13 lista uslovnog biračkog spiska

SHENIMBUK

Lista e votuesve me kusht /Uslovni birački spisak

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	/	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------	---	--------------------------	--------------------------	--------------------------

Nr. Br.	Emri Ime	Mbiemri Prezime	Numri personal i letërnjoftimit të Republikës së Kosovës apo UNMIK-ut (nëse asnjërin nga këto nuk e posedon, atëherë çfarëdo numri tjetër personal) Matični broj iz lične karte Republike Kosova ili UNMIK-a (ukoliko ne poseduje nijedan od ovih , bilo koji drugi matični broj)	Data e lindjes Datum rođenja	Nënshkrimi Potpis
0001					
0002					
0003					
0004					
0005					
0006					
0007					
0008					
0009					
0010					
0011					
0012					
0013					
0014					
0015					
0016					
0017					
0018					
0019					
0020					
0021					
0022					
0023					
0024					
0025					
0026					
0027					
0028					
0029					
0030					
0031					
0032					
0033					
0034					
0035					

SHTETMBULL



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



LISTA E VOTUESVE PËR TËRË KOMUNËN
BIRAČKI SPISAK NA NIVOU OPŠTINE

01. DEÇAN/DEČANE

42470

Votues në listë
Birača na spisku

273

Faqe në këtë listë
Stranica na ovom spisku

SHEMBULL

01. DEÇAN/DEČANE

<i>Mbiemri, Emri Prezime, Ime</i>	<i>Data e lindjes Datum rodenja</i>	<i>Nr. regjistrimit Registarski broj</i>	<i>#VV BBM</i>	<i>Mbiemri, Emri Prezime, Ime</i>	<i>Data e lindjes Datum rodenja</i>	<i>Nr. regjistrimit Registarski broj</i>	<i>#VV BBM</i>
XHERDAN SHAQIRI	01/01/1989	888885555	0101C/01R	TOMAS MULLER	12/01/1989	333333336	0105C/02D
GRANIT XHAKA	02/01/1989	999997777	0102C/02R	JURGEN KLINSMAN	13/01/2000	555555558	0101C/02R
RIVALDO DA SILVA	03/01/1989	111111111	0103C/04D	ALESANDRO COSTACURTA	14/01/1989	555555557	0103C/04D
LIONEL MESSI	04/01/1989	333333333	0101C/01R	GJANLUGJI BUFFON	15/01/1989	555555557	0103C/04D
RONALDO	05/01/1989	222222222	0105C/02D	IGLI TARE	16/01/1989	888885555	0101C/01R
VEDAT MURIQI	06/01/1989	666666666	0110C/11D	TEST TEST	17/01/1989	777779999	0105C/02D
SAMIR UJKANI	07/01/1989	777777777	0101C/03R	FILAN FISTEKU	18/01/1989	111122222	0101C/01R
ALESANDRO DELPIERO	08/01/1989	888888888	0105C/02D	QAZIM QAZIM	19/01/1989	333355555	0102C/02R
PAOLO MALDINI	09/01/1989	999999999	0101C/02R	MIHAJL MIHAJL	20/01/1989	999996666	0105C/02D
RONALDO	10/01/1989	111111119	0103C/04D	RODRIGO PAULETA	21/01/1989	333344444	0110C/11D

SHENMBULL